



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1347/Prot.
17

Patos më 05.06.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 29.05.2024

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltarë:

1. Erald Çepele
2. Ertilla Myrtaj
3. Renaldo Shpata
4. Vjollca Kasaj
5. Smerald Hazizaj
6. Elmira Rama
7. Suela Hoxhaj
8. Artan Velçani
9. Enkelejda Ajazi
10. Zejni Musaj
11. Klaudio Alisinanaj
12. Elton Seraj
13. Armand Ahmetaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit Z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përhëndetje të gjithëve! Të nderuar këshilltarë, e nderuar zv/kryetare, të nderuar specialistë të administratës, të nderuar qytetarë! Zhvillojmë këtë mbledhje në zbatim të nenit 53 pika 4 të nenit 56 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe konform rregullave të “Rregullores për Organizim dhe Funksionimin e Këshillit Bashkiak.

Kuorumi ligjor është i mbledhur, jemi 13 anëtar të këshillit prezent.

Nisim me leximin e rendit të ditës.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.04.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.04.2024.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2024”.

- 5- Projekt-vendim "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2024".
- 6- Projekt-vendim "Për miratimin e kriterëve dhe kushteve për licensimin e agjencive të shërbimit funerale në bashkinë Patos".
- 7- Projekt-vendim "Për ndarjen e kategorive të banesave në zbatim të V.K.M nr. 179, datë 26.02.2020".
- 8- Projekt-vendim "Për ndryshimin e emërimit dhe vlerës së projektit me objekt "Rikonstruksion i rrugës Vresht", miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 81, datë 18.12.2023 Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetit për vitin 2024.
- 9- Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2024.

Para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës dua t'ju njoftoj se ekzekutivi ka paraqitur një projektvendim për tu shqyrtuar në ditën e sotme i cili mban nr. prot 1351 datë 20.05.2024, **Projektvendim "Për miratimin e Raportit vjetor të konsolidimit të buxhetit dhe Performancës 2023.**

Kjo pikë nuk është paraqitur në momentin e hartimit të rendit të ditës pra në mbledhjen e kryesisë. Në zbatim të rregullores ne mund ta fusim në rendin e ditës sepse edhe në komisionin e ekonomisë është trajtuar dhe është votuar. Pra unë propozoj ta shtojmë në rendin e ditës. Kjo do jetë pika e dhjetë, projekt-vendim "Për miratimin e Raportit vjetor të konsolidimit të buxhetit dhe Performancës 2023".

Kush është dakod për miratimin e rendit të ditës?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Smerald-Hoxied
Entekajda Ajazi
Ajazi
Eshika Mykraj
Ajazi
240

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1348 Prot.
3

Patos më 05.05.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.04.2024.

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjerim për korrigjim procesverbali?

Nëse ska pyetje ose sygjerime në bazë të nenit 77 të rregullores e konsiderojmë të miratuar unanimisht procesverbalin e mbledhjes së kaluar .

Smerdet Ahmetaj

SEKRETARE
Refaela Xeba

Refaela Xeba

Enteklejola Azizi
Azizi
Edhira Mehmetaj
Ademaj
240

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1347/Prot.
19

Patos më, 05 06.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.04.2024

Armand Ahmetaj- Fjala për Refaelën!

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 30.04.2024 janë marrë gjithsej 8 vendime.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 8 vendime vendimi nr. 39 dhe 40 i është përcjell prefekturës për verifikim dhe na ka ardhur ardhur përgjigja se janë në përputhje me ligjin. Ndërsa përgjigjen e vendimit nr. 32 të mbledhjes datë 16.04.2024 j'ua kam nisur me email, besoj se e keni parë.

Armand Ahmetaj- Po faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerdet Hazretol
Enterejola Ajazi
J. J. J.
Eshler Myrtaj
Cedipudaj '24

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1341 / Prot.
3

Patos më 05.06.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2024".

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin. Kjo pikë ka kaluar në komisionin e ekonomisë dhe është votuar unanimisht për tu kaluar në këshill.

Barie Goxhaj- Përshëndetje! Për muajin Prill 2024 drejtorja e Shërbimit Social dhe Qendrës multifunksionale propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor gjithsej 19 familje me një fond prej 69,243 (gjashtëdhjetë e nëntmijë e dyqind e dyzetë e tre) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së katërt të rendit të ditës projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2024".

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerdet Hoxhëzaj
Enkelgela Ajazi
Ajazi
Erbila Murtezi
Ajazi

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1342 / Prot.
13

Patos më 05 06.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2024".

Armand Ahmetaj- Fjala për ekzekutivin.

Barie Goxhaj- Për muajin Prill 2024 nga fondi i kushtëzuar gjithsej 18 familje me një fond prej 72,901 (shtatëdhjetë e dymijë e nëntqind e një) lekë.

Armand Ahmetaj- Faleminderit Barie! Atëherë kush është dakord për Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2024".

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

Smerodol Hoxhaj

SEKRETARE
Refaela Xeba

[Signature]

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Entekjola Azizi
Azizi

Erbilaz Myrtaj
[Signature]

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1071/Prot.
7

Patos më 05.06.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e kriterëve dhe kushteve për licensimin e agjencive të shërbimit funerale në bashkinë Patos".

Armand Ahmetaj – Siç jeni në dijeni të gjithë është zhvilluar dhe një dëgjese publike në lidhje me këtë pike dhe po ashtu ka kaluar dhe në komisionin e shërbimeve i cili ka votuar unanimisht pro për tu kaluar në këshill. Megjithatë kërkojmë një raport të shkurtër nga ekzekutivi. Ekzekutivi- Ermenita Mici relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Armand Ahmetaj – Faleminderit! Ndonjë pyetje? Atëherë meqënëse nuk kemi pyetje kalojmë në miratimin e pikës gjashtë, projekt-vendim "Për miratimin e kriterëve dhe kushteve për licensimin e agjencive të shërbimit funerale në bashkinë Patos". Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerald Hoxhaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Enkejola Hoxhaj

Ermenita Mici

Armand Ahmetaj
24



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1345 / Prot.
3

Patos më 05 .05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për ndarjen e kategorive të banesave në zbatim të V.K.M nr. 179, datë 26.02.2020".

Armand Ahematj- I lutem ekzekutivit.

Ekzekutivi – Arben Shpërdheja relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Armand Ahematj- Besoj ka pyetje për këtë pikë. Unë dua tju informoj se kjo pikë është shqyrtuar në mbledhjen e komisionit të shërbimeve dhe i cili ka votuar unanimisht për tu votuar.

Artan Velçani- Doja një shpjegim nëse është e mundur. Cilat janë hapat që do të ndiqen për privatizimin e objektit i pallatit të ish parkut Patos i cili nuk ka dokumentacion?

Arben Shpërdheja- Në lidhje me privatizimin e objektit parku i naftës vendimet janë ndarë në vitin 1994, pallati ishte pa përfunduar dhe në 2005 është bërë një regjistrim i përsheptuar në tremujorin e fundit.

Ne këto pallate i kemi prona të transferuara nga enti banesave dhe pallati parkut të naftës nuk figuron. Në korrespondencën që kemi bërë me Ministrinë e Zhvillimit Urban nuk na është dhënë një përgjigje e saktë se si do veproni. Pritet dalja e VKM për pallatet e legalizuara. Ne kemi ndjekur hapat tonë ligjorë, kemi bërë planimetrinë e apartamentit, identifikimin e banorëve, janë 15 apartamente në mos gaboje por këta më pengojnë edhe 30 familje të tjera në privatizim sepse dikush ka lënë 2+1 dhe është strehuar në 2+1 pallat të ri por ka lënë mbrapa 1+ 1 dhe kjo kalon zinxhir. Ne kemi aplikuar në sistem për regjistrimin e kësaj prone por pritet një vendim i veçantë qeverie për këtë lloj apartamenti, ne nuk kemi më fuqi ligjore. Nuk kemi bazë ligjore për të bërë regjistrimin.

Artan Velçani- Unë e kuptova se ne presim si bashki një vendim qeverie. I është dërguar materiali qeverisë?

Arben Shpërdheja- Po i është dërguar.

Erald Çepele- Kisha dy pyetje në lidhje me tarifat. Sa janë tarifat sipas kategorive që do të paguajnë qytetarët për m² dhe pyëtja tjetër është që këto prona kush i administron dhe kush do ti vjeli të ardhurat e këtyre pronave? Apo i janë transferuar bashkisë?

Arben Shpërdheja - Tarifat e banesave janë përcaktuar në VKM sipas vjetërsisë ose sipas kategorizimit të ndërtimit të sipërfaqes së tyre dhe e ka ndarë më tabela VKM-ja ku kemi

- Banesat 1+1
- Banesat 2+1
- Banesat 3+1

Dhe të gjitha këto përcaktojnë me tabelë në bazë të vitit të ndërtimit, pastaj kanë kritere të tjera specifkimi ku thuhet se në bazë të certifikatës familjare që ka marrë poseduesi i kësaj banese në atë kohe kemi zbritje ose dhe shtesë ku janë përcaktuar në bazë të ligjit dhe normat e strehimit, ndërsa të ardhurat arkëtohen në buxhetin e shtetit.

Ne jemi zbatues të VKM-së të pronave të transferuara, asnjëherë të pronave të bashkisë. Kategoritë ndahen nga Vetëqeverisja Vendore, kategorinë e parë e ka përcaktuar VKM-ja , pjesa tjetër nuk ka ndryshuar që nga 2008. Sepse VKM-ja e parë doli me procedurë në 2008. Ne e kemi ndarë dhe po të kemi parasysh kemi vendimin nr. 85 të këshillit të bashkisë patos ku thuhet se për efekt privatizimi është marrë ky vendim, por meqë u ngrit komision ri u nderrua titullari i institucionit le ta rifresojkojmë vendimin. Nuk ka arsye për tu zhbër vendimi parë, është në vazhdimësi VKM 97.

Armand Ahmetaj- Doja tju njoftoja se pjesëmarrja është rritur me një këshilltare Znj. Klarida Semanjaku e cila është e pranishme.

Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër për miratim të pikës shtatë Projekt-vendim "Për ndarjen e kategorive të banesave në zbatim të V.K.M nr. 179, datë 26.02.2020".

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

Smerdet Hoxhaj

SEKRETARE
Refaela Xeba

RX

Enkeleola Ajazi
Ajazi

Erkida Myrtaj
Ajazi
26

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1346 Prot.
13

Patos më 05.06.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për ndryshimin e emërimit dhe vlerës së projektit me objekt "Rikonstruksion i rrugës Vresht", miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 81, datë 18.12.2023 Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetit për vitin 2024.

Armand Ahmetaj- Ju lutem ekzekutivi një raport.

Silvana Mici - Në zbatim të Buxhetit të Bashkisë për vitin 2024, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 81, datë 18.12.2023, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ka hartuar projektin "Rikonstruksion i rrugës Vresht". Vlera totale e miratuar ishte 32,445,000 (tridhjetë e dy milion e katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë. Mirpo gjatë fazës së hartimit të projektit është konsideruar e nevojshme zgjerimi i zonës së hyrjes së rikonstruksionit të rrugës me plotësimin e segmenteve lidhëse në brendësi të bllokut të vrshtit, me plotësim të sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe të zeza si dhe ndriçimi i të gjithë bllokut të vreshtit. Për këtë arsye për shkak të zgjerimit të bllokut të ndëryrjeve do konsiderohej më e përshtashme që objekti të emërtohej "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagjja e Re" pasi e përshkron më mirë zonën e ndërhyrjes.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë:

1. Ndryshimin e emërimit të projektit nga "Rikonstruksion i rrugës Vresht" në "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagjja e Re".
2. Ndryshimin e vlerës së projektit të miratuar në Buxhetin e vitit 2024 nga 32,445,000 lekë në 49,342,439.4 lekë.
3. Diferenca midis vlerës së miratuar në Buxhetin 2024 dhe vlerës së projektit të hartuar do të përballohet brenda tavaneve buxhetore të vitit 2025.

Klaudio Alisananaj- Ne e kemi projektin gati për këtë investim?

Silvana Mici-Po është gati.

Klaudio Alisananaj- I parashikon të gjitha këto zërat që thatë ju? Trotuar, ndriçim, kanalizim të ujrave të zeza ?

Silvana Mici-Po

Klaudio Alisananaj- Këtu mesa shikoj meqënëse është ndryshuar vlera përfshihet i gjithë blloku?

Silvana Mici - Përfshihet i gjithë blloku me gjithë segmentet lidhëse në brendësi të bllokut.

Erald Çepele- Vlera e shtuar e projektit prej 16 milion e 800 e ca mijë do të mbulohet në projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027 , ky do shtrihet në dy vjet si projekt dhe nuk do preket projekt buxheti i 2024.

Armand Ahmetaj - Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër, Projekt-vendim "Për ndryshimin e emërimit dhe vlerës së projektit me objekt "Rikonstruksion i rrugës Vresht", miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 81, datë 18.12.2023 Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetit për vitin 2024 me ndryshimet që u cituan nga specialisti Administratës.

Kush është dakord me miratimin?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smiroel Hoxhaj



KRYETAR

Armand Ahmetaj

Enkelejda Arzi
Arzi

Enkela Myrtaj
Arzi
24





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1338 Prot.
3

Patos më 05 .05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2024.

Ekzekutivi (Mimoza Shtëmbari)-Drejtoresha e Financës raporton.

Klaudio Alisinanaj- Nuk dëgjova raportin e përqindjes që është realizimi i të ardhura për këtë 4 mujor.

Mimoza Shëmbari- 16%.

Klaudio Alisinanaj- Kujt i referoheni gjithë vitit apo 4-mujorit?

Mimoza Shëmbari- Planit Vjetor.

Klaudio Alisinanaj- Nuk kemi bërë një shpërndarje të përafërt se si do jete realizimi i të ardhuarve për të tre katër mujorshit, se normalisht i përfshirë në vit ok dakord por një mesatare duhet ta bëjmë më përafërsi, duke e marrë nga eksperienca e vitit të kaluar. Dua të shikoj për këtë katër mujor, pra të bëjmë një ndarje tamam. Unë këtë mendim kisha për ta parë si katër mujor jo si vjetor dhe sa janë mbledhur këto katër muaj.

Mimoza Shëmbari- Ky propozim është i drejtë por ne e kemi të pamundur për të shpërndarë këtë realizim mujor pasi ne përsëri në këto tregues do jemi pasi arkëtimet ne nuk i detyrojmë dot ti bëjnë arkëtime që e kanë afatin deri në qershor ti detyrojmë të vijnë të bëjnë raportime. Por gjithsesi ky është një tregues që duhet të shikohet.

Ndonjë pyetje tjetër? Atëherë shkojmë në pikën tjetër

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 135 Prot.
5

Patos më 05.05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e Raportit vjetor të konsolidimit të buxhetit dhe Performancës 2023".

Ekzekutivi (Mimoza Shtëmbari)-Drejtoresha e Financës relaton materialin e përgatitur me shkrim dhe të dërguar me email.

Armand Ahmetaj- Fjala është e ekzekutivit. Një përmbledhje të shkurtër dhe të kuptueshme.

Klaudio Alisininaj- Sa janë të ardhurat për vitin 2023. Sa janë ato krahasuar në përqindje me buxhetin e miratuar? Sa ka qënë e realizuar në krahasim me 2022? Ku kanë qënë shpenzimet sipas të ardhurave të buxhetit?

Mimoza Shtëmbari- Në faqen nr. 2 të raportit janë pasqyruar burimet e planifikuara të financimit për buxhetin e vitit 2023 dhe burimet faktike të buxhetit 2023. Referuar kësaj pasqyre kemi të ardhura vendore të planifikuara për vitin 2023 janë 287 milion 999 mijë lekë ndërsa të ardhura vendore të realizuara 228,683 mijë lekë ose 81%.

Mos realizimi i të ardhurave e kemi raportuar dhe tek raporti i monitorimit të raportit të katër muajorit të tretë ku vlerën më të madhe e zë kompania bankers me 3 milion të pa arkëtuara për të cilën ne jemi në proces gjyqësor. Peshën kryesore të mos realizimit e zë kjo kompani, për faktin se jemi në proces gjyqësor dhe akoma jemi në faktin pa e zgjidhur këtë.

Atëherë kalojmë në votim projektvendimin "Për miratimin e Raportit vjetor të konsolidimit të buxhetit dhe Performancës 2023". Kush është dakord?

Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smeqet Hoxha
Enxhelida Hoxha
Hoxha
Erkida Myrtaj
Celina Hoxha

KRYETAR
Armand Ahmetaj